



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:203146  
Datë: 31.07.2024  
Numri i dokumentit: 06003947

**C.nr.1432/2021**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË/Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, si gjykatë e shkallës së parë, me gjyqtaren Vlerona Maliqi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses M. H. nga M., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Valon Mehmeti, avokat nga Mitrovica, kundër të paditurit Spitali i Përgjithshëm “Dr. S. H.”, në M., me objekt kontesti pagesën e shpërblimit jubilar, jashtë seancës, me datë 25.07.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. REFUZOHET** në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses M. H. nga M., e ushtruar kundër të paditurit Spitali i Përgjithshëm “Dr. S. H.”, në M., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri që paditëses në emër të shpërblimit jubilar, për 10 vite përvojë pune, t’ia paguajë shumën prej 529.00€ (pesëqind e njëzet e nëntë euro), me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë më datë 13.09.2021 e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.
- II.** Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësja M. H. nga M., përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar, më datë 13.09.2021, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurit Spitali i Përgjithshëm “Dr. S. H.”, në M., me objekt kontesti pagesën e shpërblimit jubilar. Në padi paditësja ka theksuar se e njëjta është në marrëdhënie pune te e paditura dhe se në momentin e parashtrimit të kësaj padie i ka mbushur

mbi 10 vite përvojë pune te e paditura, në pozitën teknik medicionale. Padiësja duke u mbështetur në dispozitën e nenit 17 par.3, nënpar.3.1 dhe par.4 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë të datës 11.06.2018, pasi që e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin e saj pavarësisht kërkesës së parashtruar nga padiësja, ka kërkuar nga gjykata që të detyrojë të paditurën që paditëses në emër të përvojës së punës për 10 vite, t’ia paguajë shumën prej 529.00€, me kamatë prej 8%, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore të cilat i ka kërkuar por nuk i ka specifikuar.

E paditura përmes përgjigjes në padi e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, me arsyetimin se kërkesa e paditëses është e pabazuar, e parashkruar dhe e pathemeltë pasi që kërkesës i mungon baza ligjore sepse Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë ka qenë në fuqi nga data 11.06.2018 deri më datë 10.06.2021, duke i propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzojë në tërësi si të pasafatshme.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 399 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimi jashtë seancës, dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadija e paditëses është e pathemeltë dhe si e tillë u refuzua.

Me dispozitën e nenit 17 par.3, nënpar.3.1 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë të datës 12.06.2018, përcaktohet se: *“Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë: për 10 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të një page mujore të tij”*.

Gjykata gjen se nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës nuk del themelësia e kërkesëpadiës së paditëses, respektivisht faktet e treguara në padi janë në kundërshtim me provat të cilat i ka bashkangjitur padiësja, pasi e njëjta nuk ka arritur t’i bëjë të besueshme gjykatës se ka 10 vite përvojë pune te e paditura, respektivisht nga vërtetimi me nr.342 i datës 10.02.2021, të cilën padiësja i’a ka bashkangjitur padisë rezulton se e njëjta është në marrëdhënie pune me këtu të paditurin nga data 01.05.2018 ndërsa padinë në gjykatë e ka parashtruar më datë 13.09.2021, që nënkupton se jo vetëm për këtë periudhë kohore por edhe në kohën kur gjykata po vendos lidhur me këtë çështje, padiësja nuk ka arritur të provojë se ka përvojë pune prej 10

vite ndërsa me dispozitën e nenit 7 par.1 të LPK-së, parashihet se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.”*.

Gjykata vlerësoi edhe provat tjera në të cilat paditësja është thirrur në padi dhe të cilat i'a ka bashkangjitur padisë, por të njëjtat ishin irelevante për të vendosur ndryshe sepse lista e pagave nuk përmbante fare datë të lëshimit, dhe pasi që paditësja nuk ka arritur që të provojë se ka përvojë pune 10 vite në institucione shëndetësore, është irelevante lartësia e pagës që ajo ka pasur, andaj gjykata vendosi të refuzojë kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar, duke vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të të paditurës të parashtruara në përgjigje në padi, mirëpo duke qenë se gjykata e refuzoi kërkesëpadinë e paditëses për faktin se nuk është dëshmuar përvoja e saj e punës prej 10 viteve, konsideroj se nuk është relevante të lëshohet në arsyetimin e pretendimeve tjera.

Vendimin që secila palë t'i bart shpenzimet e veta procedurale, gjykata e ka mbështetur në dispozitën e nenit 450 lidhur me dispozitën e nenit 463 të LPK-së, pasi që pala paditëse shpenzimet e procedurës i ka kërkuar por të njëjtat nuk i ka specifikuar ndërsa pala e paditur në anën tjetër nuk është deklaruar fare lidhur me shpenzimet e procedurës.

Nga sa u tha më lart, e konform dispozitës së nenit 143 lidhur me nenin 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**

**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil**

**C.nr.1432/2021, më datë 25.07.2024**

**G j y q t a r j a**

---

**Vlerona Maliqi**

Numri i lëndës: 2021:203146  
Datë: 31.07.2024  
Numri i dokumentit: 06003947

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.